

Njoftim per shtyp.

Mbi Memorandumin e Mirëkuptimit mes Autoritetit të Konkurrencës dhe Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve

Sot në mesditë u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit mes Autoritetit të Konkurrencës, përfaqësuar nga Kryetarja Lindita Milo (Lati) dhe Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve, përfaqësuar nga Kryetari i saj, Z. Islam Cani.

Nënshkrimi i këtij Memorandumi ka si qëllim shkëmbimin e informacionit për një zbatim sa më të mirë dhe efikas të ligjeve organike respektive dhe bazohet në të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Sipas memorandumit, Autoriteti bashkëpunon për rritjen e konkurrencës së lirë dhe efektive duke dhënë mendimet e tij në rastet e kufizimit, ndërhyrjes dhe deformimit të tregut.

Autoriteti dhe SHMK u angazhuan të bashkëpunojnë në publikimin dhe shkëmbimin zyrtarisht të të dhënave dhe informacioneve, në masën që lejojnë dhe detyrojnë ligjet mbi të cilat mbështetet ky memorandum, duke respektuar në çdo rast karakterin e tyre konfidencial.

Përmes këtij memorandumit shprehet vullneti dhe gatishmëria e drejtuesve të institucionit që komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe të dhëna të tjera të nevojshme, do të jenë një detyrim reciprok vetëm ndaj publikut dhe interesave të tij.